



**MONITORIMI I ZBATIMIT  
TË BUXHETIMIT TË  
PËRGJIGJSHËM GJINOR  
NË BASHKINË ELBASAN  
2023**



Budget  
Accountability  
and Transparency



Funded by  
the European Union



**MONITORIMI I ZBATIMIT  
TË BUXHETIMIT TË  
PËRGJIGJSHËM GJINOR  
NË BASHKINË ELBASAN  
2023**

Ky raport monitorimi është hartuar nga Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri në kuadër të projektit “Monitorimi dhe përmirësimi i zbatimit të buxhetimit dhe politikave gjinore në Bashkinë Elbasan”, me mbështetjen nga skema e granteve “BAT Civil Society”, e zbatuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim në partneritet me Faktoje dhe Center for Research and Policy Making (CRPM), mbështetur financiarisht nga Bashkimi Evropian.

Përgatiti raportin: Prof. Asoc. Dr. Nadia Peto

Autor: © Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri, Dhjetor 2024

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektin autor. Asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij.

Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e vetme e Qendrës për Drejtësi Gjinore në Shqipëri dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

## TABELA E PËRMBAJTJES

Lista e shkurtimeve .....	6
Hyrje .....	7
Qëllimi dhe objektivat e raportit .....	9
Metodologjia e përdorur për hartimin e raportit .....	10
Kufizime të raportit .....	12
Struktura e raportit .....	12
1. Kuadri ligjor kombëtar dhe detyrimet strategjike në kuadër të integrimit gjinor dhe buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në Shqipëri .....	13
1.1. Buxhetimi gjinor në Njësitë e Qeverisjes Qëndrore .....	13
1.2. Buxhetimi gjinor në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore .....	15
1.3. Buxhetimi gjinor si pjesë e detyrimeve strategjike kombëtare .....	16
1.4. Dokumentat strategjike vendore në fushën e barazisë gjinore dhe buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në bashkinë Elbasan .....	17
1.4.1. Plani Vendor për Barazinë Gjinore i Bashkisë Elbasan (2022-2024) .....	17
1.4.2. Plani i Mbrojtjes Sociale 2023-2026 në bashkinë Elbasan .....	18
1.4.3. Plani Vendor për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë Elbasan .....	20
1.5. Strukturat për Barazinë Gjinore në Bashkinë Elbasan dhe roli i tyre në mbështetjen e Buxhetimit të Përgjigjshëm Gjinor .....	21
1.5.1. Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale .....	21
1.5.2. Nëpunësi i Barazisë Gjinore .....	21
1.5.3. Komisioni i Përhershëm për Shërbimet dhe Strehimin Social, Shëndetësinë dhe Barazinë Gjinore .....	22
2. Analiza e gjetjeve të monitorimit referuar zbatimit të Buxhetimit të Përgjigjshëm Gjinor .....	22
3. Konkluzione dhe Rekomandime .....	28
3.1. Konkluzione .....	28
3.2. Rekomandime .....	29
4. Burimet e përdorura në analizë .....	31

## LISTA E SHKURTIMEVE

Buxheti i Përgjigshëm Gjinor	BPGJ
Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore	NJVV
Ministria e Financave	MF
Programi Buxhetor Afatmesëm	PBA
Instituti i Statistikave Zyrtare	INSTAT
Organizata Jofitimprurëse	OJF
Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri	QDGJSH
Këshilli Bashkiak	KB
Vendim i Këshillit Bashkiak	VKB

Buxheti vendor është instrumenti kyç mbi të cilin bashkitë ndërtojnë prioritetet e tyre dhe pasqyrojnë angazhimin ndaj mirëqenies së qytetarëve. Si një instrument vendimtar për administrimin e burimeve publike vendore, ai përfaqëson një mjet të fuqishëm për trajtimin e sfidave komplekse të zhvillimit, si pabarazia gjinore, varfëria, përjashtimi dhe padrejtësia ekonomike. Në këtë kuadër, buxheti i përgjigjshëm gjinor është një qasje thelbësore që synon të sigurojë shpërndarje dhe përdorim më të drejtë të burimeve financiare, duke adresuar nevojat dhe prioritetet specifike të grave dhe burrave. Analiza e ndikimit gjinor të shpenzimeve publike është jetike për të shmangur përkeqësimin e hendekut gjinor dhe për të promovuar barazinë në fusha ekonomike, sociale, politike dhe kulturore. Për këtë arsye, monitorimi i buxhetit me një qasje të përgjigjshme gjinore, si në nivel qendror ashtu edhe vendor, është një hap i rëndësishëm drejt një qeverisjeje të drejtë dhe gjithëpërfshirëse që pasqyron angazhimin real ndaj barazisë gjinore.

Institucionet qendrore dhe Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore (NJVV) kanë detyrime të përcaktuara qartë në lidhje me buxhetimin e përgjigjshëm gjinor, të cilat rrjedhin nga ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligji nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” si edhe udhëzimet e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë mbi përgatitjen e buxhetit vjetor dhe programit buxhetor afatmesëm. Buxheti i Përgjigjshëm Gjinor (BPGJ) është përfshirë edhe në menaxhimin e sistemit buxhetor përmes ndryshimeve të ligjit përkatës (2016). Gjithashtu, ligji për financat e vetëqeverisjes vendore (2017) ka krijuar mundësitë për përfshirjen e efektshme të BPGJ në të gjitha fazat e ciklit të menaxhimit financiar vendor (programimi i buxhetit vjetor dhe afatmesëm, monitorimi dhe raportimi, vlerësimi dhe auditimi) nga NJVV. Në mënyrë të detyrueshme, NJVV-ve u ngarkohet që të paktën në një nga objektivat e politikave të programeve duhet të adresojnë problematika të pabarazisë gjinore ose respektimin e plotë të barazisë gjinore, duke identifikuar qartazi produktet dhe treguesit gjinorë. NJVV-të gjatë raportimit duhet të përfshijnë detyrimisht si tregues financiar shpenzimet për politikën që mbështesin barazinë gjinore krahasuar me shpenzimet e përgjithshme. Gjithashtu, në Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore dhe Planin e Veprimit 2021-2030 (SKBGJ) janë përfshirë dy objektiva specifike, si pjesë e Qëllimit Nr.3 të Politikave, që lidhen drejtpërdrejtë me përfshirjen e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në nivel qendror dhe lokal: *Monitorimi i zbatimit të programeve në të cilat është aplikuar buxheti i përgjigjshëm gjinor, në nivel qendror dhe mbështetja e Njësitë të Vetëqeverisjes Vendore për njohjen dhe zbatimin e detyrimit ligjor për aplikimin e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor.*

Nisur nga detyrimet që rrjedhin nga dokumentat ligjorë të lartpërmendur, në këtë raport, Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri monitoron ndarjen e shpenzimeve publike sipas gjinisë në fushën e shërbimeve sociale, me fokus në monitorimin e zbatimit të buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në Bashkinë Elbasan.

Nevoja për analizën gjinore të shpenzimeve publike e ka bazën tek pranimi i faktit se në Shqipëri, ashtu si edhe në të gjithë botën, gratë dhe burrat priren të kenë role dhe përgjegjësi të ndryshme ekonomike, si dhe qasje të ndryshme në burimet prodhuese dhe në shumicën e rasteve, gratë priren të jenë në disavantazh.[1]

[1] Birchall.J dhe Fontana.M (2015) “The gender dimensions of expenditure and revenue policy and systems”, fq 3.

Për shembull, gratë zakonisht pritet që të marrin përsipër pjesën më të madhe të kujdesit për familjet e tyre. Kjo do të thotë se gratë (shumë më shumë se burrat) kanë barrën e dyfishtë të kryerjes së punës së paguar dhe të papaguar. Ky rol i dyfishtë shpesh ka efektin e minimumit të pozitës së grave në tregun e punës me pagesë, ku ato mund të kenë akses vetëm në një gamë të kufizuar sektorësh dhe profesionesh, dhe mund të kufizojnë mundësitë e tyre për të hyrë në tregje dhe shërbime të tjera gjithashtu. Kështu, bazuar në të dhënat e vitit 2023, 16.9 % e grave në Shqipëri mbesin jashtë forcës së punës duke përbushur detyrat shtëpiake, krahasuar me vetëm 0,8 % të burrave që kanë si arsye të inaktivitetit të tyre përbushjen e detyrave shtëpiake. [2]

Ndërkohë, struktura e të punësuarve sipas statusit të aktivitetit tregon se 45,4 % e grave janë të punësuar me pagë, ndërsa 23,5 % e tyre janë punëtore pa pagesë në biznesin e familjes. Për burrat e punësuar këto shifra janë përkatësisht 42,8 % dhe 13,2 %. [3]

Nga ana tjetër, duhet të pranojmë se barra e dyfishtë dhe pozita e pabarabartë e grave dhe burrave në familje, ka të ngjarë t'i bëjë gratë më të cenueshme brenda familjes së tyre. Vëtëm nga të dhënat e vitit 2023, rezulton se gratë përbëjnë 64.3 % të viktimave të dhunës në marrëdhënie familjare krahasuar me 30.3% të burrave.

Bazuar në sa më lart, monitorimi dhe analiza e mënyrës se si qeveritë në nivel vendor mbledhin, shpërndajnë dhe shpenzojnë paratë ka potencialin për të reduktuar ose përforcuar këto pabarazi me bazë gjinore. [4]

Një raport i tillë jo vetëm tregon rritjen e ndjeshmërisë dhe vëmendjes së organizatave të shoqërisë civile ndaj shpërndarjes së shpenzimeve publike si përgjegje ndaj nevojave të grupeve vulnerabël në shoqëri, por gjithashtu forcon kapacitetet e shoqërisë civile për të hartuar raporte që lidhen me çështje të ndjeshme gjinore dhe për të ndërmarrë iniciativa monitoruese nisur nga perspektiva gjinore.

Në të njëjtën kohë, ky raport do të konkludojë në rekomandime konkrete ndaj bashkisë Elbasan në lidhje me hartimin e buxheteve publike të përgjigjshme gjinore dhe shpërndarjen e buxheteve publike sipas nevojave të kategorive vulnerabël.

---

[2] INSTAT (2023) “Burra dhe Gra”, fq. 69.

[3] Ibid.

[4] Birchall.J dhe Fontana.M (2015) “The gender dimensions of expenditure and revenue policy and systems”, fq 3.



## QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT E RAPORTIT

Raporti paraqet gjetjet e procesit të monitorimit dhe vlerësimit të zbatimit të buxhetimit të përgjigjshëm gjinor nga bashkia Elbasan.

Objektivi kryesor i këtij raporti është të vlerësojë shkallën e shpenzimeve të realizuara gjatë vitit 2023 për përmirësimin e situatës së grave si edhe për rritjen e aksesit të grave në shërbimet sociale të ofruara nga bashkia Elbasan. Të identifikojë nivelin e arritjeve si edhe të ngrejë çështjet më problematike të kësaj fushe në drejtim të strukturave shtetërore në nivel vendor.

Në mënyrë të përmbledhur si objektiva të raportit të monitorimit mund të përmendim:

- Të analizojë ndarjen e shpenzimeve gjinore të ofruara gjatë vitit 2023 nga bashkia Elbasan;
- Të eksplorojë nivelin e plotësimit të detyrimeve strategjike në fushën e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor me qëllim garantimin e aksesit të grave në shërbimet sociale vendore;
- Të identifikojë problemet praktike në fushën e mbledhjes dhe analizës së të dhënave mbi shpenzimet buxhetore të ndara sipas gjinisë brenda bashkisë Elbasan;
- Të ofrojë rekomandime konkrete mbi rritjen e proaktivitetit të Bashkisë në drejtim të zbatimit të detyrimeve për hartimin e buxheteve të përgjigjshme gjinore si dhe buxhetimin e masave me rëndësi për përmirësimin e situatës së barazisë gjinore në vend dhe rritjen e aksesit të grave në sferën e shërbimeve publike.

Për sa më sipër, mund të themi se gjetjet e këtij raporti do t'i shërbejnë:

- aktorëve shtetërorë të përfshirë në ofrimin e shërbimeve publike brenda bashkisë Elbasan;
- organizatave jofitimprurëse në Shqipëri që janë aktive në fushën e politikave të ndjeshme gjinore dhe buxhetimit të përgjigjshëm gjinor;
- organizatave rajonale/ndërkombëtare aktive që punojnë për të njëjtin qëllim, si edhe
- çdo personi të interesuar në zbatimin e detyrimeve strategjike dhe ligjore mbi buxhetimin e përgjigjshëm gjinor.

## METODOLOGJIA E PËRDORUR PËR HARTIMIN E RAPORTIT

Hartimi i këtij raporti është mbështetur në një kombinim të metodave cilësore dhe sasiore në terma të analizës së detyrimeve ligjore të organeve të qeverisjes vendore lidhur me buxhetimin e përgjigjshëm gjinor dhe detyrimeve strategjike në drejtim të **aplikimit të integritit gjinor si mjeti kryesor për arritjen e barazisë dhe drejtësisë gjinore në shoqëri** dhe analizës sasiore të monitorimit të realizimit të shpenzimeve të dedikuara për gratë në fushën e shërbimeve sociale vendore.

Fillimisht, me qëllim përcaktimin e sferës së shtrirjes së monitorimit, u analizuan të gjitha kategoritë e shërbimeve sociale të ofruara në nivel vendor për gratë dhe u identifikuan programet buxhetore që lidheshin në mënyrë të drejtpërdrejtë me secilin prej këtyre shërbimeve dhe programet buxhetore që përmbanin produkte specifike gjinore.

Në kuadër të mbledhjes së të dhënave, QDGJSH dërgoi në bashkinë Elbasan, kërkesën për informacion të detajuar mbi:

- masat e marra dhe buxhetet përkatëse në fushën e aksesit të grave në shërbimet sociale për vitin 2023;
- nivelin e shpenzimeve të realizuara në fund të vitit 2023 për të njëjtat kategori shërbimesh;
- arsyet e mosrealizimit të shpenzimeve të planifikuara për programet e shërbimeve sociale për gratë (në rast të mosrealizimit të plotë të shpenzimeve të planifikuara në buxhetin vjetor).

Pjesë e metodologjisë së mbledhjes së të dhënave ka qenë edhe kryerja e takimeve me përfaqësuesit e bashkisë Elbasan që kanë në fokus të veprimtarisë së tyre përgatitjen e buxhetit apo shërbimet sociale.

Sa më sipër, u realizuan pranë bashkisë Elbasan takime me:

- a) përfaqësues të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financës;
- b) përfaqësues nga Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale, Sektori i Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Barazisë Gjinore;
- c) përfaqësues nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale, si edhe
- d) përfaqësues nga Drejtoria e Integritit Evropian, Projekteve dhe Donatorëve.

Gjithashtu, si burim informacioni për mbledhjen e të dhënave mbi buxhetimin gjinor, kanë shërbyer edhe anekset e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor të programeve buxhetore afatmesme 2023-2025 si edhe raportet e realizimit të shpenzimeve lidhur me secilin program buxhetor për vitin 2023.

Në terma cilësor, objekt analize kanë shërbyer të gjitha dokumentat ligjore/politike dhe strategjike vendore që kanë përfshirë si pjesë të qëllimeve të tyre politike apo objektiva specifike integrimin e perspektivës gjinore në ofrimin e shërbimeve publike dhe buxhetimin e shërbimeve publike sipas nevojave të vecanta të burrave dhe grave.

Në kuadër të kësaj, kanë shërbyer si objekt analize:

- ligji për Financat e Vetëqeverisjes Vendore;
- udhëzimet standarde për hartimin e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në nivel vendor;
- Plani Social Vendor për bashkinë Elbasan 2023-2026;
- Plani Vendor i Veprimit për Barazinë Gjinore 2022-2024;
- Plani i Integritit të Pakicave;
- Dokumente politikash të hartuara nga bashkia Elbasan në fushën e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor.

Lidhja ndërmjet detyrimeve strategjike dhe buxheteve të realizuara ndihmon për të hedhur dritë dhe analizuar jo vetëm shkallën e përfshirjes së parimeve të barazisë gjinore në politika e strategji, por edhe në përkthimin e tyre në buxhete që u përgjigjen në mënyrë të barabartë nevojave të ndryshme të burrave dhe grave.

## KUFIZIME TË RAPORTIT

**Së pari**, ky raport merr përsipër të analizojë të dhënat mbi ndarjen e shpenzimeve publike në fushën e shërbimeve sociale në terma të përgjithshëm vetëm për gratë. Ky kufizim vjen për shkak të mungesës së të dhënave të ndara sipas moshës, origjinës etnike, aftësisë së kufizuar apo gjendje tjetër vulnerabiliteti në të gjitha programet objekt monitorimi. Megjithatë, për aq sa është e mundur, bazuar në të dhënat zyrtare të mbledhura në nivel vendor, raporti përmban edhe të dhëna të shpenzimeve publike specifike për gratë viktime të dhunës në familje, viktime të trafikimit, gra kryefamiljare, gra rome/egjiptiane, etj.

**Së dyti**, referuar shtrirjes së periudhës së monitorimit, raporti përmban analizën mbi rezultatet e monitorimit të zbatimit të buxhetimit të përgjigjshëm gjinor vetëm për periudhën Janar – Dhjetor 2023.

**Së treti**, raporti përmban të dhëna lidhur me realizimin e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor vetëm në bashkinë Elbasan. Në këtë kuptim të dhënat e analizuara për efekt të këtij raporti dhe gjetjet e monitorimit nuk mund të përdoren dhe/ose përgjithësohen edhe për bashkitë të tjera që nuk janë objekt monitorimi.

## STRUKTURA E RAPORTIT

Bazuar në metodologjinë e mësipërme, raporti i monitorimit përbëhet nga 3 pjesë:

**Pjesa e parë:** Kuadri ligjor dhe detyrimet strategjike në kuadër të integritimit gjinor dhe buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në nivel vendor.

**Pjesa e dytë:** Analiza e shpenzimeve buxhetore sipas gjinisë për shërbimet publike të ofruara në bashkinë Elbasan: Gjetjet e procesit të monitorimit.

**Pjesa e tretë:** Përfundime dhe Rekomandime.

## 1. Kuadri ligjor kombëtar dhe detyrimet strategjike në kuadër të integrimit gjinor dhe buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në Shqipëri

Buxhetimi i Përgjigjshëm Gjinor është një mjet për të siguruar që angazhimet e ndërmarra politike për arritjen dhe respektimin e barazisë gjinore në nivel të pushtetit qendror dhe njësive të vetëqeverisjes vendore, të reflektohen dhe realizohen në praktikë nëpërmjet buxhetit.

Në terma më specifike, BPGJ është një mjet i njohur botërisht që siguron arritjen e barazisë gjinore nëpërmjet:

- përfshirjes së një perspektive gjinore në të gjitha nivelet e procesit buxhetor dhe ristrukturimin e të ardhurave dhe shpenzimeve për të promovuar barazinë gjinore;
- bashkërendimit të përpjekjeve për barazi gjinore dhe menaxhimit të financave publike;
- analizimit të ndikimeve të ndryshme që politikat fiskale dhe buxhetore kanë mbi gratë dhe burrat;
- kontributit që ofron në alokimin me efikasitet dhe efektivitet të fondeve buxhetore.[5]

Në këtë kuptim, BPGJ është analizuar për qëllime të këtij raporti si mjet për të integruar perspektivën gjinore në të gjithë hapat e procesit buxhetor – planifikim, hartim, zbatim dhe vlerësim – për të siguruar që politika buxhetore në nivel qendror dhe vendor merr në konsideratë çështjet gjinore në shoqëri.[6]

Bazuar në kuptimin më sipër, Avokati i Popullit në monitorimin e shpenzimeve publike në fushën e shërbimeve sociale nuk është ndalur në analizën e programeve buxhetore në terma të përcaktimit të buxheteve të ndara për gratë dhe vajzat, apo thjesht rritjen e alokimeve buxhetore të veçanta për këto grupe, por në analizën e shpërndarjes së shpenzimeve buxhetore që adresojnë pabarazitë e vazhdueshme midis grave / vajzave dhe burrave / djemve.[7]

### 1.1. Buxhetimi gjinor në Njësitë e Qeverisjes Qëndrore

Në terma ligjorë, njësitë e qeverisjes qendrore kanë detyrime të përcaktuara qartë për përfshirjen e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor si pjesë e programit buxhetor afatmesëm. Me ndryshimet e ligjit nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar në vitin 2016, parimi i barazisë gjinore u shtua si pjesë e parimeve të funksionimit të sistemit buxhetor. Bazuar në nenin 4, shkronja e) e ligjit nr. 9936/2008, **barazia gjinore i referohet situatës ku burri dhe gruaja gëzojnë mundësi dhe akses të barabartë në të drejta dhe përfitime të së njëjtës natyrë.**[8]

---

[5] Udhëzim nr. 23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së “Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”, shtojca nr.4.

[6] UN Women, “Buxhetimi i Përgjigjshëm Gjinor në Shqipëri. Një manual për punonjëset dhe punonjësit e administratës publike qendrore dhe vendore”, fq 15, Shtator 2019.

[7] Ibid.

[8] Shih ligjin nr. 57/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Ndryshimet në ligjin e sipërcituar i hapën rrugë për herë të parë përfshirjes së buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në menaxhimin e sistemit buxhetor. Në të njëjtën kohë, përfshirja e parimit të “barazisë gjinore” në ligjin organik të buxhetit të shtetit, i hapi rrugë hartimit të akteve nënligjore për përgatitjen e Buxhetimit të Përgjigjshëm Gjinor në nivel qëndror dhe vendor.

Kështu, në nivel qëndror, baza ligjore për hartimin e BPGJ është udhëzimi nr. 7/2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”, në të cilën përcaktohet metodologjia e buxhetimit në bazë programi dhe performance për hartimin e PBA. Ky udhëzim ngarkon titullarët e njësisë të qeverisjes qëndrore me përgjegjësinë për të siguruar që dokumenti i programit buxhetor afatmesëm krahas parimeve të tjera të sistemit buxhetor të respektojë edhe parimin e barazisë gjinore.

Për garantimin e këtij standardi, Udhëzimi ngarkon nëpunësit autorizues në rolin e koordinatorit të Grupit të Menaxhimit Strategjik që gjatë dy fazave të hartimit të kërkesave buxhetore, të sigurojnë përfshirjen minimalisht të një qëllimi të politikës që adreson respektimin e plotë të barazisë gjinore ose promovon barazinë gjinore në fushën/sectorin përkatës për secilin program buxhetor në përgjegjësinë e tyre.[9]

Gjithashtu, udhëzimi parashikon se aty ku gjykohet e aplikueshme, në bashkërendim me ministrinë përgjegjëse për financat, programet buxhetore duhet të evidentojnë objektiva konkretë me bazë gjinore të shoqëruara me tregues të përshtatshëm dhe të matshëm performance.[10]

Me qëllim planifikimin e objektivave si edhe matjen e progresit të arritur në fushën e barazisë gjinore, udhëzimi parashikon si pjesë të përgjegjësisë të nëpunësve të autorizuar për marjen e masave të nevojshme për të mundur evidentimin, mbledhjen dhe administrimin e të dhënave të disagreguara sipas gjinisë. Të njëjtat parashikime përcaktohen në udhëzim edhe në drejtim të Drejtuesit të Programit Buxhetor. [11]

Në terma më specifike, shtojca nr. 5 e Udhëzimit nr. 7/2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm”, e titulluar “Udhëzime mbi përgatitjen e Buxhetimit të Përgjigjshëm Gjinor” parashikon se “në përputhje me parimin e barazisë gjinore, të gjitha programet buxhetore, duhet të përcaktojnë të paktën një objektiv me bazë gjinore të shoqëruar me tregues performance respektive në nivel objektiv dhe produkti. Aty ku është e aplikueshme, programet buxhetore duhet të përcaktojnë apo reflektojnë qëllime të politikës në përputhje të plotë me qëllimet strategjike të arritjes së barazisë gjinore të përcaktuara në SKZHI, strategjitë ndërsektoriale dhe sektoriale, duke evidentuar qartë dhe treguesit përkatës të performancës.”[12]

Gjithashtu, në udhëzimin vjetor të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm, parashikohet ndër të tjera se të gjitha ministritë e linjës dhe institucionet e tjera buxhetore qëndrore, duhet të kryejnë analiza me bazë gjinore të sektorit përkatës, me qëllim:

- përcaktimin e objektivave dhe treguesve të performancës me bazë gjinore, që ndihmojnë në kryerjen e analizave gjinore të sektorit përkatës dhe matjen e performancës së programit buxhetor;
- detajimin e objektivave me bazë gjinore në produkte dhe kosto, të cilat synojnë zbutjen e pabarazive gjinore apo/dhe arritjen e barazisë gjinore, aty ku është e mundur.

9] Udhëzimi nr. 7/2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm, kreu 2.4, pika 6, shkronja i.

[10] Ibid, shkronja j.

[11] Udhëzimi nr. 7/2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm, kreu 2.4, pika 6, shkronja k.

[12] Shtojca nr.5 e Udhëzimit nr. 7/2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm, kreu 2.5, pika 5, shkronja h.

## 1.2. Buxhetimi gjinor në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore.

Në nivel vendor, baza kryesore ligjore për hartimin e BPGJ është ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar. Në nenin 2, “Qëllimi i ligjit” është përcaktuar se ligji ka për qëllim të sigurojë që në krijimin dhe shpërndarjen e burimeve financiare vendore të njërive të vetëqeverisjes vendore të përshpejtohet dhe realizohet barazia gjinore. Në përputhje me këtë parim, të gjitha programet buxhetore, aty ku është e mundur, duhet të përcaktojnë të paktën një objektiv me bazë gjinore të shoqëruar me tregues performance respektive në nivel objektiv dhe produkti.

Gjithashtu, në pikën 4 të nenit 36 “Programi Buxhetor Afatmesëm Vendor”, përcaktohet se PBA përfshin informacion për qëllimet e politikave të programeve, projektet e investimeve publike, produktet e programeve dhe kostot e tyre përkatëse. Sipas shkronjës c të kësaj pike “*të paktën një nga objektivat e politikave të programeve duhet të adresojë problematika të pabarazisë gjinore ose respektimin e plotë të barazisë gjinore duke identifikuar qartazi produktet dhe treguesit e tjerë të matshëm me bazë gjinore.*”[13]

Në terma të hartimit të raporteve të monitorimit, nenin 54 i ligjit nr. 68/2017 “Raportimi financiar”, parashikon në mënyrë specifike se treguesit financiarë që publikohen, përfshijnë por nuk kufizohen në raportin e shpenzimeve për politikën që mbështesin barazinë gjinore ndaj shpenzimeve të përgjithshme.

Bazuar në ligjin nr. 68/2017, Ministria përgjegjëse për çështjet e financave ka hartuar udhëzimin nr. 23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njërive të vetëqeverisjes vendore”. Në pjesën e parë të udhëzimit “Të përgjithshme” përcaktohet si më poshtë:

*“Qëllimet e politikës të programit, objektivat e politikës së programeve, produktet e programeve dhe kostot përkatëse, shoqëruar me treguesit e performancës. Të paktën një nga objektivat e politikave sipas programeve duhet të adresojë problematika të pabarazisë gjinore ose respektimin e plotë të barazisë gjinore, duke identifikuar qartazi produktet dhe treguesit e tjerë të matshëm me bazë gjinore”.*

Ky udhëzim përcakton edhe përgjegjësitë e Kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore lidhur me buxhetimin me bazë gjinore. Kështu, Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore në rolin e kryetarit të Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS), ka përgjegjësinë të drejtë, koordinojë GMS dhe të garantojë pjesëmarrjen e drejtuesit të çdo programi buxhetor, në seancat dëgjimore të buxhetit të organizuara me komunitetin. Gjithashtu, në këtë rol ai ka si përgjegjësi:

- të japë udhëzime në lidhje me identifikimin e qëllimeve, objektivave të politikës së programit për të gjithë drejtuesit e programeve, duke siguruar që për çdo program respektohet barazia gjinore ose promovimi i saj;
- të kërkojë nga drejtuesit e programeve që të evidentojnë, mbledhin dhe administrojnë të dhëna sipas gjinisë në mënyrë që të planifikohen qëllimet dhe objektivat me bazë gjinore si dhe për të matur progresin në lidhje me to.

Në pikën 38 të udhëzimit, përcaktohet në mënyrë specifike, se Drejtuesit e Ekipit të Menaxhimit të Programit janë përgjegjës për:

[13] Ligj nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 36, pika 4/c.

*f. Përcaktimin për programin buxhetor në përgjegjësinë e tyre të minimalisht një qëllimi të politikës që adreson respektimin e plotë të barazisë gjinore ose promovon barazinë gjinore në fushën/sectorin përkatës. Aty ku gjykohet e aplikueshme, të përcaktojnë objektiva konkretë me bazë gjinore të shoqëruara me tregues të përshtatshëm dhe të matshëm performance, ku do të synohet që të identifikohet një ose disa produkte me kostot përkatëse që do të kontribuojnë në realizimin e tyre.*

Shtojca nr. 4 e udhëzimit përmban një informacion të detajuar për buxhetimin gjinor në njësitë e vetëqeverisjes vendore duke parashikuar se në përputhje me parimin e barazisë gjinore të përcaktuar në ligjin Nr. 68, datë Nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, të gjitha programet buxhetore në njësitë e qeverisjes vendore, aty ku është e mundur, duhet të përcaktojnë të paktën një objektivi me bazë gjinore të shoqëruar me tregues performance respektive në nivel objektivi dhe produkti. Gjithashtu, në këtë shtojcë parashikohet se “*aty ku është e aplikueshme, programet buxhetore duhet të përcaktojnë apo reflektojnë qëllime të politikës në përputhje të plotë me:*

- *qëllimet strategjike të arritjes së barazisë gjinore të përcaktuara në SKZHI, strategjitë sektoriale vendore;*
- *planet e zhvillimit vendor;*
- *udhëzimet e Kryetarit të Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore;*
- *udhëzimet e Këshillit të Njesisë së Vetëqeverisjes Vendore.*

Për të siguruar adresimin e drejtë të pabarazive dhe diskriminimit, në kuadër të procesit të buxhetimit të përgjigjshëm gjinor dhe përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm, njësia e vetëqeverisjes vendore, rekomandohet të ndjekë hapat e mëposhtëm:

1. analiza e situatës në një sektor të caktuar, i burrave, grave, djemve dhe vajzave;
2. vlerësimi i nivelit të përgjigjshmërisë (gjinore) së legjislacionit, politikave dhe programeve;
3. vlerësimi i shpërndarjes së buxheteve;
4. monitorimi i shpenzimeve dhe shërbimeve;
5. vlerësimi i rezultateve (impaktit).

Në kuadër të përgatitjes së raporteve të monitorimit, Udhëzimi nr. 22 datë 30.07.2022 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësive të vetëqeverisjes vendore” parashikon në shtojcën 2 “Përmbajtja e raportit të monitorimit” se relacioni shpjegues për çdo format duhet të përfshijë ecurinë e realizimit të qëllimeve, dhe objektiveve të politikës që trajtojnë çështjen e barazisë gjinore nëpërmjet treguesve të performancës.

Bazuar në detyrimet e sipërcituara, vlen të nënvizojmë se hartimi i buxheteve të përgjigjshme gjinore në nivel qendror dhe lokal nuk është vetëm i lidhur me vullnetin e njësive të qeverisjes qendrore dhe vendore, por gjithashtu një detyrim ligjor që duhet të merret parasysh në çdo fazë gjatë hartimit të programeve buxhetore.

### **1.3. Buxhetimi gjinor si pjesë e detyrimeve strategjike kombëtare**

Në nivel strategjik, buxhetimi i përgjigjshëm gjinor ka qënë pjesë e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim (SKZHI) 2015- 2020, duke u vendosur në këtë mënyrë në strategjinë ombrellë të të gjithë kuadrit strategjik në Shqipëri.



Në harmonizim me SKZHI, koncepti i buxhetimit të përgjigjshëm gjinor është përkthyer në objektiva specifike dhe masa si pjesë e Strategjisë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030. Konkretisht, Qëllimi strategjik IV i kësaj strategjie “*Aplikimi i integritetit gjinor si mjet për arritjen e barazisë dhe drejtësisë gjinore në shoqëri*” parashikon dy objektiva specifike të lidhur me zbatimin e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në nivel qendror dhe vendor:

**Objektivi specifik IV.2:** Monitorimi i zbatimit të programeve në të cilat është aplikuar buxheti i përgjigjshëm gjinor, në nivel qendror.

**Objektivi specifik IV.3:** Mbështetja e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore për njohjen dhe zbatimin e detyrimit ligjor për aplikimin e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor.

Për arritjen e objektivave të mësipërm, SKBGj 2021-2030 ka detajuar në planin e saj të veprimit masat konkrete për t’u zbatuar nga njësitë e qeverisjes qendrore dhe vendore me qëllim arritjen e këtyre rezultateve:

- buxheti i alokuar dhe i shpenzuar në lidhje me programet buxhetore të raportuara si programe të ndjeshme gjinore, në nivel qendror, i monitoruar dhe raportuar;
- buxhetet e NJVV reflektojnë zbatimin korrekt të legjislacionit mbi aplikimin e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor.

Pikërisht, bazuar në detyrimet ligjore të parashikuara në ligjin nr. 57/2016 “*Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”*” i ndryshuar dhe ligjin nr. 68/2017 “*Për financat e vetëqeverisjes vendore*” si edhe detyrimet strategjike të parashikuara në Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030, pjesa në vazhdim e raportit do të përpikët të analizojë gjendjen e zbatimit të buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në njësitë e qeverisjes qendrore dhe vendore që janë objekt i këtij raporti. Konkretisht raporti do të analizojë realizimin e një prej treguesve financiarë më të rëndësishëm të buxhetimit të përgjigjshëm gjinor që lidhet me analizën e shpenzimeve për politikën që mbështesin barazinë gjinore.

## **1.4. Dokumentat strategjike vendore në fushën e barazisë gjinore dhe buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në bashkinë Elbasan**

### **1.4.1. Plani Vendor për Barazinë Gjinore i Bashkisë Elbasan (2022-2024)[14]**

Plani Vendor për Barazinë Gjinore (PVBGJ) për Bashkinë Elbasan është një dokument kyç që synon të përmbushë angazhimet e bashkisë për barazinë gjinore gjatë periudhës 2022-2024 në përputhje me Kartën Evropiane për Barazinë e Grave dhe Burrave në Jetën Vendore.[15] Kjo Kartë, e nënshkruar nga Bashkia Elbasan, përcakton standarde të qarta dhe detyra specifike për qeverisjen vendore për të promovuar barazinë gjinore dhe përfshirjen sociale në nivel lokal. Ky plan ka si synim parashikimin e masave dhe aktiviteteve specifike për të zbatuar angazhimet e Kartës dhe për të fuqizuar gratë, vajzat dhe grupet e tjera të marginalizuara në të gjitha aspektet e jetës sociale, ekonomike dhe politike. Në këtë kontekst, Plani Vendor për Barazinë Gjinore është pjesë e përpjekjeve të bashkisë për të përfshirë perspektivën gjinore në çdo aspekt të shërbimeve dhe politikave vendore, duke siguruar që fondet publike të përdoren për të përmbushur

[14] Shih për më tepër tekstin e plotë të Planit Vendor për Barazinë Gjinore 2022-2024 tek <https://elbasani.gov.al/sherbimet/qendra-sociale-balashelplanin-vendor-te-barazise-gjinore/>

[15] Shih për më tepër tekstin e plotë të Planit Vendor për Barazinë Gjinore 2022-2024 tek <https://elbasani.gov.al/sherbimet/qendra-sociale-balashelplanin-vendor-te-barazise-gjinore/>

nevojat e ndryshme të burrave dhe grave, vajzave dhe djemve në komunitet.

Një nga drejtimet kryesore të ndërhyrjes që është parashikuar në kuadër të këtij plani është: **Avancimi i Kornizës së Përgjithshme të Barazisë Gjinore, realizimi i së cilit synon progresin e bashkisë Elbasan** në terma të buxhetimit të përgjigjshëm gjinor dhe përfshirjen e perspektivës gjinore në të gjitha politikat dhe planet vendore.

Për të arritur këtë, bashkia ka vendosur objektiva specifike që përfshijnë krijimin e strukturave të reja për analizimin e ndikimit gjinor dhe publikimin e raporteve periodike mbi përparimin e GRB-së, të cilat do të jenë të aksesueshme për qytetarët dhe partnerët institucionalë. Gjithashtu, plani përfshin zhvillimin e kapaciteteve të stafit për të zbatuar në mënyrë të suksesshme buxhetimin e përgjegjshëm gjinor, duke përfshirë trajnime për analiza gjinore dhe përdorimin e indikatorëve për monitorimin e progresit. Kjo qasje do të rrisë besimin e qytetarëve të bashkisë, duke dëshmuar një angazhim të vazhdueshëm për barazinë gjinore dhe përkushtimin ndaj një qeverisjeje të hapur dhe të drejtë. Rezultati i pritshme të parashikuara në Plan dhe që lidhen me buxhetimin e përgjigjshëm gjinor është: **Zbatimi i Buxhetimit të Përgjigjshëm Gjinor** sipas legjislacionit, duke përfshirë perspektivën gjinore në politikat dhe dokumentet kryesore të bashkisë.

Ndërkohë që në terma të objektivave specifike plani parashikon:

**Objektivi Specifik 2: “Zbatimi i Detyrimeve për Integrimin e Perspektivës Gjinore dhe Buxhetimin e Përgjigjshëm Gjinor në Nivel Lokal”:**

- publikimi i raporteve të monitorimit të buxhetit nga perspektiva gjinore në faqen e bashkisë.
- monitorimi i dokumenteve të rëndësishme lokale nga perspektiva gjinore.

Gjithashtu, në termat të monitorimit të zbatimit të objektivave të parashikuara në Planin Vendor të Barazisë Gjinore për efekte të buxhetimit të përgjigjshëm gjinor, është parashikuar si indikator kryesor:

I.2.a: Numri i raporteve të **shpenzimeve të buxhetit të monitoruara nga perspektiva gjinore**, të publikuara në faqen e bashkisë.

#### **1.4.2. Plani i Mbrojtjes Sociale 2023-2026 në bashkinë Elbasan [16]**

Plani i Mbrojtjes Sociale Elbasan (Plani Social) 2023- 2026 përshkruan prioritetet e Bashkisë Elbasan në fushën e përfshirjes dhe mbrojtjes sociale deri në vitin 2026. Ai përmban gjithashtu një listë masash që ndikojnë në përfshirjen sociale dhe luftimin e varfërisë, burimet njerëzore dhe fondet publike (qendrore dhe vendore) dhe jopublike të parashikuara për mbështetjen, riintegrimin dhe përfshirjen sociale të njerëzve dhe familjeve në nevojë. Ky plan bazohet në vizionin afatgjatë të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për përfshirjen sociale që synon t'i sigurojë çdo qytetari shqiptar, burrë, grua, djalë apo vajzë, pavarësisht të ardhurave, origjinës, moshës, gjinisë, etnisë, edukimit, orientimit seksual, identitetit kulturor, bindjeve politike e fetare, shërbime publike cilësore, të cilat rikonceptohen me prioritet familjen dhe duke adresuar “qasjen e ciklit të jetës”. Një nga parimet kryesore ku mbështetet Plani Social Vendor është zbatimi i parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, sipas të cilit mbrojtja sociale ofrohet për çdo individ në nevojë, pavarësisht nga gjinia apo përkatësitë e tjera.

[16] Shih për më tepër tekstin e plotë të Planit Vendor Social 2023-2026 tek <https://elbasani.gov.al/wpcontent/uploads/2023/09/Draft-Plani-Social-2023-2026-Bashkia-Elbasan-11.pdf>

Një komponent kyç i Planit është buxhetimi i përgjegjshëm gjinor, i cili siguron që fondet dhe burimet e alokuara të adresojnë në mënyrë të drejtë nevojat e grave, burrave, fëmijëve dhe grupeve të tjera të marginalizuara. Të dhënat analitike të Planit tregojnë shpërndarjen e përfitimeve sociale të ndara sipas gjinisë, duke evidentuar rëndësinë e buxhetimit gjinor për të siguruar që të gjitha grupet përfitojnë në mënyrë të drejtë nga shërbimet sociale. Për shembull, 144 gra dhe vajza në nevojë janë përfituese të shërbimeve specifike sociale, ndërsa për familjet me kryefamiljare gra (37) është ofruar mbështetje e drejtpërdrejtë për t'u siguruar që këto familje të kenë akses më të mirë në shërbime bazë dhe mbështetje ekonomike.

Për të mbështetur një qasje gjithëpërfshirëse, Plani parashikon që 70 familje në nevojë të përfitojnë ndihmë sociale, ku mbi gjysma prej tyre (53%) janë me kryefamiljare gra. Ky fokus në përfshirjen gjinore siguron që mbështetja e ofruar nga bashkia të adresojë nevojat specifike të grave dhe grupeve vulnerabël. Plani synon gjithashtu që fëmijët dhe të rinjtë, përfshirë ata me aftësi të kufizuara, të kenë qasje në shërbime të dedikuara, me një vëmendje të veçantë për balancimin e shpërndarjes së ndihmës midis gjinive. Nga këto grupe, 532 fëmijë në nevojë përfitojnë ndihmë, duke përfshirë 249 fëmijë me aftësi të kufizuara dhe 44 të rinj, ku raporti gjinor i përfituesve tregon shpërndarjen në mënyrë të diferencuar, për të përmbushur nevojat specifike të secilit grup.

Në mënyrë të përgjithshme, Plani i Mbrojtjes Sociale ndihmon bashkinë Elbasan që të zbatojë buxhetimin e përgjegjshëm gjinor duke siguruar që fondet publike të alokuara të reflektojnë dhe përmbushin në mënyrë të drejtë nevojat gjinore të popullsisë. Kjo qasje synon të promovojë barazinë gjinore dhe të përmirësojë aksesin në shërbime për të gjithë qytetarët, duke ndihmuar kështu në ndërtimin e një komuniteti më të fortë dhe të drejtë për të gjithë banorët e Elbasanit.

Në mënyrë më specifike të dhënat në lidhje me kategoritë përfituese për shërbimet e ofruara në nivel të bashkisë Elbasan të ndara sipas gjinisë paraqiten në tabelën si më poshtë:

Kategoritë Përfituese	Përfitues Total	Të ndarë sipas gjinisë		Të ndarë në përqindje sipas gjinisë	
		Gra dhe Vajza	Burra dhe Djem	Gra dhe Vajza	Burra dhe Djem
Fëmijë në nevojë	532	249	283	47%	53%
Fëmijë me aftësi të kufizuara	249	61	188	24%	76%
Të rinj në nevojë	44	10	34	23%	77%
Të rritur me aftësi të kufizuara	61	16	45	26%	74%
Gra dhe vajza në nevojë	144	144		100%	
Të moshuar në nevojë	98	28	70	29%	71%
Familje në nevojë	70	37	N/A	53%	

**Burimi:** Plani Social Vendor 2023-2026, Bashkia Elbasan, tabela analitike e kategorive përfituese për shërbimet e ofruara publik/jopublik.

### 1.4.3. Plani Vendor për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane në Bashkinë Elbasan<sup>[17]</sup>

Plani Vendor për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane për Bashkinë Elbasan është një dokument gjithëpërfshirës që synon të mbështesë integrimin social dhe ekonomik të këtyre pakicave, duke përfshirë fusha prioritare si arsimit, punësimi, strehimi, mbrojtja sociale dhe shëndetësia. Një aspekt kyç i këtij plani është integrimi i parimeve të barazisë gjinore dhe buxhetimit të përgjegjshëm gjinor, duke siguruar që masat dhe shpenzimet të jenë të ndjeshme ndaj nevojave të grave dhe burrave të komuniteteve rome dhe egjiptiane.

Përfshirja e Parimeve të Barazisë Gjinore dhe Buxhetimit Gjinor në Planin e Integritit synohet të realizohet në disa fusha kryesore:

**1. Arsimit:** Në sektorin e arsimit, plani parashikon masa për të reduktuar shkallën e braktisjes shkollore dhe për të rritur përfshirjen e fëmijëve romë dhe egjiptianë në shkolla. Buxhetimi i Përgjegjshëm Gjinor siguron që këto masa të adresojnë në mënyrë specifike nevojat e vajzave dhe djemve nga këto komunitete, duke përfshirë mbështetje shtesë për vajzat që shpesh hasin barriera të shtuara kulturore dhe ekonomike për vijimin e shkollimit.

**2. Punësimi dhe Zhvillimi i Aftësive:** Plani synon të rrisë mundësitë e punësimit për anëtarët e pakicave, veçanërisht për gratë rome dhe egjiptiane, të cilat përballen me nivele të larta të papunësisë. Me një qasje të ndjeshme ndaj gjinisë, fondet e alokuara për kurse të formimit profesional dhe programe të punësimit sigurohen për të mbështetur pjesëmarrjen e grave, duke u dhënë përparësi kurseve që përputhen me nevojat e tyre. Kjo përfshirje ndihmon në fuqizimin e grave dhe uljen e varfërisë në nivel familjar.

**3. Strehimi dhe Infrastrukturat:** Një nga aspektet e rëndësishme të Planit është strehimi, ku janë përfshirë masa për të përmirësuar kushtet e banimit për familjet rome dhe egjiptiane. Buxhetimi gjinor i kushton vëmendje të veçantë familjeve të kryesuar nga gra, duke siguruar subvencione të posaçme dhe fonde për banesa sociale që mundësojnë përmirësimin e kushteve të jetesës për familjet më të cenueshme, veçanërisht ato me kryefamiljare gra.

**4. Shëndetësia:** Plani adreson përfshirjen e pakicave në shërbime shëndetësore bazike dhe përfshin masa për përmirësimin e aksesit në kujdesin shëndetësor për të gjithë anëtarët e komunitetit, me vëmendje të posaçme ndaj grave dhe fëmijëve. Kjo përfshirje siguron mbështetje për programe edukative për kujdesin shëndetësor, duke ndihmuar gratë që të kenë qasje të drejtpërdrejtë në këto shërbime.

**5. Mbrojtja Sociale dhe Ndihma Ekonomike:** Në kuadër të mbrojtjes sociale, Plani synon të sigurojë mbështetje financiare për familjet e varfra, ku gratë kryefamiljare përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të përfituesve. Përmes buxhetimit gjinor, fondet e destinuar për ndihmë ekonomike dhe shërbime të tjera sociale alokohen në mënyrë që të përmbushin nevojat specifike të grave dhe burrave, duke reduktuar pabarazitë ekonomike.

Sa më sipër, zbatimi i buxhetimit të përgjegjshëm gjinor brenda Planit për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane jo vetëm që ndihmon në përmbushjen e nevojave specifike të këtyre komuniteteve, por gjithashtu kontribuon në rritjen e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave në këto komunitete.

[17] Shih për më tepër: <https://irca.al/wp-content/uploads/2021/03/Plani-Vendor-Elbasan.pdf>

Kjo qasje bën të mundur një ndarje më të drejtë të burimeve dhe përfshirjen e perspektivës gjinore në të gjitha fushat e shërbimeve vendore, duke e bërë bashkinë një model për qeverisje të drejtë dhe gjithëpërfshirëse.

### **1.5. Strukturat për Barazinë Gjinore në Bashkinë Elbasan dhe roli i tyre në mbështetjen e Buxhetimit të Përgjigjshëm Gjinor**

Në nivelin e bashkisë Elbasan janë krijuar disa struktura kyçe për të mbështetur dhe promovuar barazinë gjinore. Këto struktura janë përgjegjëse për integrimin e perspektivës gjinore në politikat dhe shërbimet lokale, duke luajtur gjithashtu një rol të rëndësishëm në buxhetimin e përgjigjshëm gjinor.

#### **1.5.1. Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale**

Në krye të strukturave bashkiake për barazinë gjinore qëndron Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes Sociale, e cila ka një mandat të gjerë për zhvillimin e politikave që promovojnë mbrojtjen sociale dhe përfshirjen gjinore. Brenda kësaj drejtorie, funksionon edhe Sektori i Mbrojtjes së Fëmijëve dhe Barazisë Gjinore, i cili luan një rol kyç në sigurimin që programet sociale të adresojnë nevojat e grupeve të ndryshme gjinore dhe grupet vulnerabël, duke përfshirë gratë dhe fëmijët. Ky sektor siguron që shërbimet sociale, sidomos ato për grupet vulnerabël, të jenë të ndjeshme ndaj gjinisë. Ai ndihmon gjithashtu në monitorimin e zbatimit të buxhetimit gjinor dhe përshtatjen e shërbimeve për të përmbushur nevojat e të dyja gjinive.

#### **1.5.2. Nëpunësi i Barazisë Gjinore**

Një nga risitë dhe iniciativat e bashkisë Elbasan lidhet me planifikimin brenda organigramës së bashkisë së një pozicioni të dedikuar për çështjet e barazisë gjinore. Nëpunësi i Barazisë Gjinore është një pozicion i dedikuar dhe i veçantë në Bashkinë Elbasan që nga viti 2021, i ndarë nga koordinatori vendor kundër dhunës në familje. Nëpunësi ka për qëllim kryesor trajtimin e çështjeve gjinore në përputhje me legjislacionin dhe politikat kombëtare, duke luajtur një rol të rëndësishëm në mbledhjen e të dhënave dhe monitorimin e politikave gjinore në nivel lokal. Në përputhje me përshkrimin e detyrave të këtij pozicioni vlen të përmendim se nëpunësi i barazisë gjinore duan një rol të rëndësishëm në lidhje me:

**1. Mbledhjen dhe analizimin e statistikave gjinore:** Nëpunësi mbledh të dhëna të ndara sipas gjinisë, të cilat shërbejnë për vlerësimin dhe planifikimin e buxhetimit gjinor. Mbledhja e të dhënave të ndara sipas gjinisë është një nga instrumentat kyç për zbatimin efektiv të buxhetimit të përgjigjshëm gjinor.

**2. Raportimi dhe informimi periodik:** Nëpunësi gjinor përgatit raporte periodike që përfshijnë progresin në zbatimin e politikave dhe aktiviteteve gjinore, duke mbështetur transparencën dhe llogaridhënien e bashkisë në çështjet e barazisë gjinore.

**3. Promovimi i barazisë gjinore në nivel vendor:** Nëpunësi gjinor organizon dhe mbështet aktivitete për ndërgjegjësimin e komunitetit dhe promovimin e barazisë gjinore në bashkëpunim me aktorë të ndryshëm lokalë.

### 1.5.3. Komisioni i Përhershëm për Shërbimet dhe Strehimin Social, Shëndetësinë dhe Barazinë Gjinore

Komisioni i Përhershëm për Shërbimet dhe Strehimin Social, Shëndetësinë dhe Barazinë Gjinore është një strukturë e përhershme e krijuar në nivel të Këshillit Bashkiak dhe përbëhet nga pesë gra këshilltare dhe dy burra këshilltarë. Ky komision mbikëqyr dhe mbështet politikatat sociale dhe të shëndetit, me fokus të veçantë në barazinë gjinore, duke siguruar që nevojat dhe shqetësimet gjinore të jenë pjesë integrale e vendimmarrjes së bashkisë. Komisioni vlerëson dhe miraton plane dhe buxhete të ndjeshme ndaj gjinisë, duke ofruar një mbështetje të rëndësishme për zbatimin efektiv të buxhetimit të përgjigjshëm gjinor. Ai ndihmon gjithashtu në orientimin e politikave dhe shërbimeve për t'u siguruar që ato janë gjithëpërfshirëse dhe të ndjeshme ndaj gjinisë. Në terma të integritimit të perspektivës gjinore në politikën sociale vendore, Komisioni promovon politikatat që i përgjigjen nevojave specifike gjinore, duke siguruar që shërbimet e strehimit, shëndetësisë dhe të tjera të jenë të drejta dhe të aksesueshme për të gjithë, pavarësisht gjinisë.

## 2. Analiza e gjetjeve të monitorimit referuar zbatimit të Buxhetimit të Përgjigjshëm Gjinor

Gjatë vitit 2023, bashkia Elbasan ka administruar dhe menaxhuar fonde për 27 programe buxhetore nga të cilat 21 programe janë pjesë e buxhetit të bashkisë dhe 6 programe i takojnë fondeve nga transfertat e kushtëzuara. Në fushën e shërbimeve sociale përfshihen programi “Kujdesi Social” dhe programi “Strehimi Social”. Në terma buxhetore, shpenzimet e planifikuara në total për të gjitha programet buxhetore për vitin 2023 kanë qenë 5,974,710 mijë lekë, nga të cilat në fund të vitit u shpenzuan 4,608,571 mijë lekë ose 77%. Ndërkohë, referuar dy programeve të monitoruara mund të themi se programi “Kujdesi Social” u realizuar në fund të viti 2023 në masën 97%, 1,951,754 mijë lekë ( fakt) nga 2,018,685 mijë lekë (plan)) dhe programi “Strehimi Social” u realizua në masën 73 %, 26,912 mijë lekë ( fakt) nga 36,944 mijë lekë (plan).[18]

Për vitin 2023, programi “Kujdesi Social” ka zënë një peshë të konsiderueshme në buxhetin vjetor të bashkisë. Shpenzimet e planifikuara për realizimin e objektivave të këtij programi përbënin 33% të shpenzimeve totale të planifikuara për realizimin e të gjitha programeve buxhetore. Ndërkohë, në terma të përgjithshme, raporti i shpenzimeve të bashkisë për politikatat e kujdesit social ndaj shpenzimeve të përgjithshme ishte në masën 42%.

Ndërkohë, referuar shpenzimeve që mbështesin barazinë gjinore, evidentohet se raporti i shpenzimeve të bashkisë për politikatat që mbështesin barazinë gjinore për vitin 2023 ka qenë 0.01%. Ajo që konstatohet në këtë drejtim, është jo vetëm fakti që pesha që zenë shpenzimet për politikatat e barazisë gjinore është shumë e ulët, por gjithashtu edhe fakti që pothuajse nga viti 2021, ky raport nuk ndryshon. Në analizë të raportit vjetor të realizimit të buxhetit për vitin 2023, evidentohet se për vitet 2021-2025 planifikimi për shpenzimet e barazisë gjinore është në masën 0.01% të buxhetit vjetor të bashkisë. Ky raport minimal ka mbetur i pandryshuar pothuajse që prej vitit 2021, duke sugjeruar një mungesë përparësie dhe vëmendjeje ndaj politikave të barazisë gjinore në planifikimin buxhetor të bashkisë.

[18] Bashkia Elbasan, Këshilli Bashkiak “Raporti i monitorimit të buxhetit për 4-mujorin e tretë (janar – dhjetor) 2023”.

Kjo situatë evidenton një nevojë urgjente për rishikimin dhe rritjen e fondeve të dedikuara për politikat e barazisë gjinore. Shpenzimet e ulëta në këtë fushë ndikojnë në kapacitetin e bashkisë për të zbatuar politika gjithëpërfshirëse dhe për të mbështetur në mënyrë të mjaftueshme nevojat specifike të burrave dhe grave, veçanërisht për grupet e marginalizuara. Për të përmbushur në mënyrë efektive angazhimet ndaj barazisë gjinore dhe për të përmirësuar mbështetjen për këto politika, është thelbësore që bashkia të rrisë përqindjen e fondeve të dedikuara për barazinë gjinore në vitet e ardhshme, duke e bërë buxhetimin më të ndjeshëm ndaj nevojave të ndryshme gjinore dhe më gjithëpërfshirës për të gjithë qytetarët e Elbasanit.

Po kështu, referuar realizimit të shpenzimeve me burim financimi transfertën e kushtëzuar vihet re se për vitin 2023, rreth 4% të transfertës së kushtëzuar e përbëjnë shpenzimet e planifikuara për fondet për bursat e nxënësve, bonuse strehimi dhe mbështetje për viktimat e dhunës në familje. Për këto të fundit, nga transfertat e kushtëzuara ishin planifikuar 4,344 mijë lekë nga të cilat në fund të vitit 2023 u realizuan 3,852 mijë lekë ose 88%.

Në terma të programeve të veçanta, qëllimi i programit “Kujdesi Social” është zhvillimi i programeve në mbështetje të familjeve dhe fëmijëve në nevojë. Ky program përmbante një tregues performancë të ndjeshëm gjinor “gra viktimat të dhunës në familje të trajtuara me mbështetje”. Në të njëjtën kohë një nga produktet e këtij programi për 2023 ishte “Viktima të dhunës në familje dhe/ose viktimat të trafikimit të mbështetura nga Bashkia”. Megjithatë, nëse i referohemi raportit të realizimit të buxhetit për këtë bashki për vitin 2023, vëmë re se për këtë produkt nuk ka të dhëna as në terma të planifikimit buxhetor, as në terma të realizimit.

Po kështu, ajo që konstatohet nga raporti i realizimit të shpenzimeve është fakti se në këtë raport ka të dhëna vetëm për disa nga programet kryesore të bashkisë: Programi i Administratës Vendore, Infrastrukturës Rrugore, Shërbimet Publike, Mjedisi dhe Mbrojtja e Pyjeve dhe Kullotave, dhe Programi i Arsimit Parauniversitar dhe Edukimit. Mungojnë në këtë kontekst të dhëna si për sa i përket programeve të Kujdesit Social dhe Strehimit Social, ashtu edhe analiza referuar zbatimit të buxhetimit të përgjigjshëm gjinor, konform udhëzimit të monitorimit të buxhetit vendor nga Ministri i Financave.

Bazuar në të dhënat e ofruara nga vetë bashkia Elbasan, shpenzimet e planifikuara nga shpenzimet e veta për produktet e programit “Përkujdesja Sociale” në kuadër të viktimave të dhunës në familje dhe trafikimit, barazisë gjinore si edhe numrin e përfituesve nga produkti Ndhurma Ekonomike për Vitin 2023 paraqiten në tabelat si më poshtë:[18]

Programi	Emërtimi i Produktit	Shuma (mijë lekë) Plan	Shuma (mijë lekë) Fakt
Përkujdesja Sociale	Shpenzime për Viktimat e Dhunës në Familje	3154	900

Ndërkohë për produktin “Barazia Gjinore” janë planifikuar vetëm 500 mijë lekë në totalin e buxhetit të bashkisë, shumë e cila nuk ndikon në terma të ndjeshëm në përmirësimin e gjendjes së barazisë gjinore në nivel të bashkisë. Siç e përmendëm edhe më sipër, të dhënat lidhur me treguesin “Raporti i shpenzimeve për politikën që mbështesin barazinë gjinore ndaj shpenzimeve të përgjithshme” janë në masën 0.01% si në lidhje me shpenzimet e planifikuara ashtu edhe ato të realizuara.

Tabela: Numri i përfituesve të skemës së ndihmës ekonomike për vitin 2023.

<b>Ndihma Ekonomike</b>	
<b>Nr. i familjeve në total</b>	<b>4683</b>
<b>Viktima të Dhunës</b>	<b>66</b>
<b>Kryefamiljare Gra</b>	<b>402</b>
<b>Fondi i Bashkisë: Kryefamiljare Gra</b>	<b>17</b>
<b>Transferta 6%: Kryefamiljare Gra</b>	<b>102</b>

Në total, raporti midis numrit të përfituesve gra kundrejt numrit total të përfituesve nga skema e ndihmës ekonomike është 8%.

Bazuar në tabelën si më sipër, mund të themi se në bashkinë Elbasan ndihma ekonomike shërben si një mbështetje thelbësore për shumë familje në nevojë, por analizat tregojnë se përfitimi i grave kryefamiljare dhe viktimave të dhunës mbetet relativisht i kufizuar, duke theksuar një nevojë për rritje të buxhetit dhe për një ndarje më të drejtë të fondeve. Siç evidentohet në të dhënat e marra nga bashkia, nga 4683 familje që marrin ndihmë ekonomike në nivel bashkiak, 402 prej tyre janë familje me kryefamiljare gra, çka përfaqëson një përqindje të konsiderueshme të përfituesve. Këto gra shpesh përballen me sfida të shtuara për të mbajtur familjen, veçanërisht në kushtet e një përkrahjeje të kufizuar ekonomike dhe sociale. Për më tepër, 66 gra janë identifikuar si viktima të dhunës, një grup që kërkon ndihmë të posaçme jo vetëm në aspektin ekonomik, por edhe për riintegrim dhe mbështetje psikologjike.

Në aspektin e fondeve të bashkisë, vetëm 17 nga këto gra kryefamiljare kanë përfituar ndihmë të drejtpërdrejtë nga fondet lokale. Kjo shifër tregon kufizimet në kapacitetet e financimit të bashkisë për të adresuar nevojat specifike të grave që kryesojnë familjet. Në të njëjtën kohë, 102 gra kanë përfituar nga një skemë transferte që mbulon 6% të fondit për ndihmë ekonomike. Ky fond shtesë përpiket të lehtësojë disa nga sfidat ekonomike të këtyre familjeve, por ende mbetet një mbështetje e vogël për të përmbushur nevojat bazike të tyre.

Për sa më sipër, në lidhje me këtë produkt, konkludohet se ndërsa bashkia Elbasan ka marrë disa masa për të mbështetur gratë kryefamiljare dhe viktimat e dhunës, pesha e ndihmës mbetet e ulët dhe shpërndarja e fondeve nuk i përgjigjet plotësisht kërkesave të këtyre grupeve vulnerabel. Për të përmirësuar situatën, bashkia do të duhet të rishikojë dhe rrisë buxhetin për ndihmën ekonomike, duke synuar një alokim më të drejtë dhe të ndjeshëm ndaj gjinisë që të mundësojë përmirësimin e kushteve të jetesës dhe fuqizimin e grave kryefamiljare dhe viktimave të dhunës.



Ndërkohë, në lidhje me programin “Strehimi Social”, vlen të theksojmë që në fillim se për vitin 2023, ai ka zënë një peshë të vogël në buxhetin vjetor të bashkisë Elbasan. Vetëm 0.6 % e shpenzimeve totale janë planifikuar për realizimin e produkteve të këtij programi. (36,944 mijë lekë kundrejt totalit prej 5,974,710 mijë lekë), buxhet ky që është realizuar në masën 73% në fund të vitit 2023.

Produkti kryesor që Bashkia ka ofruar gjatë 2023 në lidhje me këtë program ka qënë “Bonus Qeraje”, ku evidentojmë se kanë përfituar gjithsej 287 shtetas vulnerabël. Megjithatë ajo që konstatohet në raportin e realizimit të buxhetit dhe anekset e tij është fakti se treguesit e performancës për këtë produkt nuk janë të ndarë sipas gjinisë, gjë që e bën të pamundur analizën e integritit të perspektivës gjinore në lidhje me këtë produkt.

Në raport është vendosur si produkt “Subvencionim qiraje i shtetasve vulnerabel” gjithsej. Megjithatë, nga informacioni i marrë pranë bashkisë Elbasan konstatohet se fokus i këtij programi janë: viktimat e dhunës dhe prindër që kanë në ngarkim fëmijë. Edhe për këtë program, mungojnë objektiva dhe tregues të ndjeshëm gjinore. Në të njëjtën kohë, raporti i monitorimit nuk paraqet një analizë të shpenzimeve buxhetore në terma të produkteve, me qëllim evidentimin e të dhënave mbi produktet që mund të kenë impakt në përmirësimin e jetës ekonomike dhe sociale të grave dhe vajzave në nivel bashkie.

Një çështje kritike e ngritur mbi produktet e strehimit social lidhet me kufizimet e bonusit të qirasë, i cili aktualisht hapet vetëm gjatë muajve shtator-tetor. Kjo krijon një pengesë të madhe për të gjitha gratë dhe vajzat që ndodhen në situata emergjente, si divorc, dhunë në familje apo marrja e një urdhri mbrojtjeje gjatë pjesës tjetër të vitit, duke i lënë nënat e vetme dhe familjet e prekura pa mbështetje për qira.

Pikërisht, duke vlerësuar nevojën në rritje për strehim/pagesë qiraje të rasteve të vajzave/grave viktimat të dhunës në marrëdhëniet familjare përgjatë gjithë vitit, nga bashkia Elbasan u pa e arsyeshme krijimi i një zëri në buxhetin e bashkisë rreth 2,000,000 lekë për të mbuluar nevojat për strehimin/pagesën e qirasë në rastet e dhunës në familje. Kjo iniciativë e bashkisë u konkretizuar përmes miratimit të Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 53 datë 31.05.2024 “Mbi shtesë e të ardhurave të trashëguara dhe shpenzime për vitin 2024” që përfshin edhe miratimin për shumën e planifikuar për këtë zë në vlerën 2,000,000 lekë. Iniciativa sa më sipër duhet të vlerësohet si një mekanizëm me rëndësi që synon të mbështesë viktimat e dhunës në familje për strehim social gjatë gjithë vitit, dhe jo vetëm në periudhën e aplikimeve për programet e Strehimit Social. Kjo nismë përfshihet në kuadrin e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor dhe adreson në mënyrë më efektive nevojat urgjente të grave dhe vajzave të prekura nga dhuna.

Megjithatë, për të plotësuar më mirë kërkesat e këtij grupi vulnerabël, rekomandohet rritja e këtij fondi rezervë/emergjence. Kjo do të sigurojë që çdo grua apo vajzë, që përjeton situata të tilla emergjente, të ketë akses të vazhdueshëm në mbështetje për strehim, duke përforcuar kështu efektivitetin dhe qëndrueshmërinë e programeve sociale të bashkisë.

## **2.1. Iniciativa të tjera me rëndësi në lidhje me buxhetimin e përgjigjshëm gjinor:**

### **2.1.1. Projekti “Integrimi i pakicave etnike Rome dhe Egjiptiane përmes arsimit dhe punësimit”**

Në vitin 2023, bashkia Elbasan në bashkëpunim me Fondacionin për Ballkanin Perëndimor “Shoqëria e Hapur për Shqipërinë” ka vijuar mbështetjen për përfshirjen dhe integrimin e minoriteteve rom dhe egjiptian përmes projektit “Integrimi i pakicave etnike Rome dhe Egjiptiane përmes arsimit dhe punësimit”. Ky projekt, përkon gjithashtu me Planin e Barazisë Gjinore të Bashkisë Elbasan, duke kontribuar në mënyrë konkrete për përfshirjen dhe fuqizimin e grave nga këto minoritete.

Gjatë vitit 2023, si rezultat i këtij projekti janë punësuar 14 përfitues nga komunitetet rom dhe egjiptian, prej të cilave 11 janë gra, të angazhuara në punësim të pjesshëm dhe të përfshira në skema të ndryshme mbështetëse. Ky angazhim u ka dhënë atyre jo vetëm mundësinë e integritit social, por edhe të kontribuojnë në jetën dhe aktivitetin social të qytetit. Për më tepër, për të nxitur vazhdimësinë e arsimit dhe për të ulur braktisjen shkollore, projekti ka siguruar bursa dhe materiale didaktike për një vit për 30 fëmijë nga këto komunitete, duke mbështetur kështu një të ardhme më të sigurt për ta dhe familjet e tyre.

Ky projekt është cilësuar nga bashkia Elbasan si pjesë e nismave afatgjata të bashkisë për të kontribuar në rritjen e barazisë gjinore dhe për të fuqizuar gratë dhe vajzat nga grupet në nevojë.

### **2.1.2. Mbështetja për Fuqizimin e Grave Rurale dhe Zhvillimi i Kurseve të Prindërimit Pozitiv në Bashkinë Elbasan**

Në vitin 2023, bashkia Elbasan ka vijuar me përpjekjet për fuqizimin ekonomik dhe social të grave, veçanërisht për ato që jetojnë në zona rurale, duke zhvilluar një seri aktivitete në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile. Ky angazhim përfshin nisma për mbështetjen e grave në punësim dhe krijimin e mundësive për të marrë pjesë në kurse të prindërimit pozitiv, të cilat synojnë të përmirësojnë jo vetëm aftësitë e tyre profesionale dhe sociale, por edhe mirëqenien e fëmijëve dhe familjeve të tyre.

#### **a. Fuqizimi Ekonomik i Grave të Papuna**

Sipas të dhënave të bashkisë Elbasan, për vitin 2023, në nivel bashkie janë të regjistruar 4151 punëkërkes të papunë, nga të cilët 2371 janë gra dhe vajza[19]. Ky numër i lartë i grave të papuna evidenton nevojën për politika të fuqishme që mbështesin integrimin e tyre në tregun e punës. Bashkia Elbasan, përmes partneritetit me organizata lokale, po synon të zhvillojë programe që t’u mundësojnë këtyre grave përmirësimin e aftësive profesionale dhe përgatitjen për punësim. Këto iniciativa përfshijnë ofrimin e trajnimeve për aftësi specifike që janë të kërkuara në tregun lokal të punës, si dhe ndihmën për krijimin e bizneseve të vogla ose aktiviteteve të qëndrueshme për gratë që jetojnë në zona rurale.

#### **b. Kursi i Prindërimit Pozitiv**

Një tjetër aspekt kyç i këtyre aktiviteteve është zhvillimi i kurseve të prindërimit pozitiv. Këto kurse janë dizenuar për t’i ndihmuar prindërit (gra dhe burra) që të përfitojnë njohuri të rëndësishme për edukimin dhe kujdesin ndaj fëmijëve, bazuar në metoda të qasjes pozitive. Prindërimi pozitiv përfshin zhvillimin e teknikave që ndihmojnë në krijimin e një mjedisi mbështetës për rritjen e fëmijëve dhe përmirësimin e komunikimit ndërmjet prindërve dhe fëmijëve.

[19] Bashkia Elbasan, Statistika Vendore 2023, tek <https://elbasani.gov.al/wp-content/uploads/2024/04/Statistika-vendore-2023-Elbasan.pdf>

Kjo ndikon jo vetëm në përmirësimin e jetës së përditshme për këto familje, por gjithashtu forcon stabilitetin dhe mirëqenien e komunitetit në tërësi.

Konkretisht, gjatë vitit 2023, Qendra Komunitare Multifunksionale Shushicë organizoi katër aktivitete mujore me grupet e prindërimit, duke ofruar sesione informuese dhe ngritje kapacitetesh për prindërit e 45 fëmijëve përfitues të qendrës. Aktivitetet u zhvilluan mbi bazën e një plani të strukturuar që adresonte nevojat e prindërve, duke përfshirë çështje si menaxhimi i financave familjare, të drejtat e grave, dhe menaxhimi i stresit të fëmijët etj. Nga 85 prindër të regjistruar (45 gra dhe 40 burra), vetëm 22 morën pjesë aktive (19 gra dhe 4 burra), duke treguar një angazhim të kufizuar, veçanërisht nga prindërit meshkuj. Zhvillimi i këtyre kurseve ka ndikuar në rritjen e ndërgjegjësimit dhe ofrimin e mbështetjes për prindërit pjesëmarrës, por gjithashtu evidenton nevojën për qasje dhe strategji të reja që mundësojnë një përfshirje më të gjerë dhe të barabartë të të dyja gjinive, duke adresuar veçanërisht barrierat që kufizojnë pjesëmarrjen e prindërve meshkuj.

### **c. Përfitimet e Programit për Gratë Rurale**

Këto përpjekje kanë ndikim të veçantë për gratë që jetojnë në zona rurale, të cilat shpesh përballen me sfida të mëdha ekonomike dhe sociale, si papunësia dhe mungesa e aksesit në trajnime profesionale. Duke u ofruar mundësi për punësim dhe përmirësimin e aftësive prindërore, bashkia Elbasan synon të mbështesë gratë rurale që të kenë një rol më aktiv në zhvillimin ekonomik të familjeve të tyre dhe të marrin pjesë në aktivitete që përmirësojnë standardet e jetesës së tyre. Ky program përfshin edhe trajnime për gratë mbi menaxhimin financiar të familjes dhe zhvillimin e aftësive për përballimin e sfidave të përditshme.

Megjithatë, edhe pse këto nisma janë të dobishme, niveli i papunësisë së grave në bashkinë Elbasan tregon nevojën për zgjerimin e mëtejshëm të këtyre programeve. Bashkia mund të konsiderojë rritjen e buxhetit të dedikuar për fuqizimin ekonomik të grave, sidomos atyre në zona rurale, dhe zhvillimin e kurseve të përparuara profesionale që u japin mundësi më të mëdha për punësim. Gjithashtu, rritja e bashkëpunimit me sektorin privat dhe OJF-të mund të ndihmojë në krijimin e mundësive të reja për gratë që përballen me papunësinë dhe përfshirjen në kurse të specializuara për përmirësimin e aftësive të tyre.

### 3. Konkluzione dhe Rekomandime

#### 3.1. Konkluzione

Bazuar në gjetjet e analizuara gjatë raportit, arrihen disa konkluzione me rëndësi si më poshtë vijon:

1. Angazhimi për Barazinë Gjinore përmes Nënshkrimit të Kartës Evropiane për Barazinë Gjinore në Jetën Vendore: Bashkia Elbasan ka bërë një hap të rëndësishëm drejt avancimit të barazisë gjinore duke nënshkruar Kartën Evropiane për Barazinë e Grave dhe Burrave në Jetën Vendore. Ky nënshkrim përfaqëson një angazhim zyrtar për të promovuar dhe zbatuar politika që mbështesin barazinë gjinore dhe përfshirjen sociale në nivel lokal.

2. Hartimi i Planit Vendor për Barazinë Gjinore: Bashkia Elbasan ka miratuar Planin Vendor për Barazinë Gjinore, një dokument strategjik që synon të integrojë perspektivën gjinore në të gjitha politikat dhe shërbimet e saj. Ky plan është një qasje e qartë për të siguruar që burimet e bashkisë përdoren në mënyrë që përmbushin nevojat e ndryshme të grave dhe burrave, duke avancuar objektivat e barazisë gjinore. Megjithatë mbetet me rëndësi monitorimi i zbatimit të Planit me qëllim që të shihet shkalla e realizimit të aktiviteteve të parashikuara në të.

3. Rritja e kapaciteteve të punonjësve për Buxhetimin e Përgjigjshëm Gjinor: Një tjetër arritje e bashkisë Elbasan është trajnimi i stafit për buxhetimin e përgjigjshëm gjinor. Përmes këtyre trajnimeve, punonjësit janë pajisur me njohuritë për të analizuar ndikimin gjinor të shpenzimeve dhe për të siguruar që buxheti të jetë gjithëpërfshirës dhe i ndjeshëm ndaj nevojave gjinore.

4. Zbatimi i Projekteve për Gratë dhe Vajzat Vulnerabël: Bashkia Elbasan ka realizuar disa projekte të rëndësishme të fokusuar në mbështetjen e grave dhe vajzave vulnerabël. Këto projekte kanë synuar përmirësimin e kushteve të jetesës dhe fuqizimin social-ekonomik të grave në situata të vështira, përfshirë viktimat e dhunës dhe gratë kryefamiljare, duke krijuar kështu një ndikim pozitiv dhe të qëndrueshëm në komunitet.

Megjithatë, me gjithë masat dhe arritjet referuar zbatimit të buxhetimit të përgjigjshëm gjinor, analiza nxorri në pah edhe disa konkluzione të tjera që meritojnë të jenë në vëmendje të autoriteteve vendore pranë bashkisë Elbasan:

5. Shpenzimet e Pamjaftueshme për Barazinë Gjinore: Shpenzimet për barazinë gjinore mbeten të ulëta, duke zënë vetëm 0.01% të buxhetit të përgjithshëm të bashkisë Elbasan. Ky nivel minimal fondesh thekson nevojën për përkushtim më të madh dhe për një buxhet më të orientuar drejt avancimit të politikave të barazisë gjinore.

6. Fokus i Kufizuar i Shërbimeve Sociale për Gratë dhe Vajzat: Vetëm 2 nga 27 programet e administruara nga bashkia fokusohen drejtpërdrejt në përmirësimin e jetës ekonomike të grave dhe vajzave, gjë që shton nevojën për kryerjen e një analize më të thellë gjinore me qëllim shtimin e numrit të produkteve buxhetore që adresojnë nevojave gjinore në politikat sociale.

7. Mungesa e Treguesve dhe Objektivave Gjinorë në Programet Buxhetore: Për programet buxhetore mungojnë objektivat dhe treguesit e ndjeshëm gjinorë, gjë që e bën të vështirë matjen dhe monitorimin e ndikimit të programeve për grupet vulnerabël dhe për barazinë gjinore në tërësi. Mungojnë gjithashtu të dhënat e ndara gjinore në terma të raportimit të realizimit të treguesve të performancë për programet buxhetore në nivel bashkie.

### 3.2 Rekomandime

Bazuar në analizën e kryer për efekt të këtij raporti, rekomandohet:

1. Rritja e Shpenzimeve të Planifikuara për Barazinë Gjinore: Ndërsa bashkia tashmë ka demonstruar një përkushtim ndaj buxhetimit të përgjigjshëm gjinor, ajo duhet të vazhdojë të ndajë burime adekuate për shërbime sociale gjithëpërfshirëse për gratë dhe vajzat. Kjo do të sillte jo vetëm një rritje të shpenzimeve për produktet e ndjeshme gjinore, por gjithashtu do të ndikonte pozitivisht në përmirësimin e jetës së vajzave dhe grave vulnerabël. Gjithashtu, me rëndësi është shtimi i numrit të produkteve të ndjeshme gjinore në buxhetet e bashkisë për periudhat e ardhshme dhe rritja e përqindjes së buxhetit të dedikuar për politikën e barazisë gjinore, duke siguruar mbështetje më të gjerë për gratë dhe vajzat, veçanërisht ato në situata të vështira ekonomike dhe sociale. Një buxhet më i madh për barazinë gjinore do të mundësonte zhvillimin e projekteve që adresojnë nevojat specifike të grave dhe vajzave, duke kontribuar në një shoqëri më të drejtë dhe gjithëpërfshirëse.

2. Hartimi i Objektivave dhe Treguesve të Ndjeshëm Gjinor për Programet Sociale: Rekomandohet që bashkia të hartojë objektiva dhe tregues performancë të ndjeshëm gjinor për çdo program social dhe të përfshijë tregues të veçantë gjinorë në raportet e performancës vjetore. Kjo masë do të ndihmojë në matjen e ndikimit gjinor të shpenzimeve buxhetore dhe do të përmirësojë transparencën dhe përgjegjshmërinë në politikën sociale.

3. Përmirësimi i Mbledhjes së Të Dhënave të Ndara sipas Gjinive: Bashkia Elbasan duhet të sigurojë një sistem të mirëfilltë për mbledhjen e të dhënave të ndara sipas gjinive për të gjitha programet buxhetore dhe aktivitetet e saj. Kjo do të ofrojë një bazë të vlefshme për analizat gjinore dhe për vlerësimin e ndikimit të programeve sociale në barazinë gjinore.

4. Zgjerimi i Skemës së Bonusit të Qirasë dhe Fondit të Emergjencës për Gratë Vulnerabël: Rekomandohet që bashkia të zgjerojë skemën e përfitimit nga bonusi i qirasë dhe të rrisë fondin e emergjencës për gratë dhe vajzat viktime të dhunës në familje. Kjo do të sigurojë që të gjitha rastet emergjente të kenë mbështetje të vazhdueshme, pavarësisht periudhës së aplikimit.

5. Rritja e Mbështetjes për Gratë Kryefamiljare dhe Viktimat e Dhunës në Familje: Bashkia duhet të zgjerojë programet e mbështetjes për gratë kryefamiljare dhe viktimat e dhunës në familje, duke përfshirë strehimin e përkohshëm, ndihmën me ushqime dhe mbështetjen ekonomike për përmbushjen e nevojave bazë.

6. Zgjerimi i Programeve për Punësimin dhe Trajnimin Profesional të Grave: Rekomandohet zgjerimi i programeve të trajnimit profesional dhe punësimit për gratë, veçanërisht për ato që jetojnë në zona rurale. Ky investim në aftësitë profesionale të grave do të ndihmojë në përmirësimin e kushteve të jetesës dhe pavarësinë e tyre ekonomike.

7. Përfshirja e Informacionit mbi Buxhetimin e Përgjigjshëm Gjinor në Raportin e Realizimit të Shpenzimeve Buxhetore: Është e rëndësishme që raporti i realizimit të shpenzimeve buxhetore i bashkisë Elbasan të përmbajë të dhëna të detajuara mbi Buxhetimin e Përgjigjshëm Gjinor. Ky informacion do të ofronte transparencë dhe do të lehtësonte analizën e alokimeve dhe shpenzimeve të dedikuara për politikën dhe programet që mbështesin barazinë gjinore. Përcaktimi i qartë i shpenzimeve të ndara për BPGJ do të ndihmonte qytetarët dhe organizatat të kuptojnë ndikimin real të këtyre shpenzimeve në përmirësimin e barazisë gjinore në komunitet.

8. Përfshirja e Treguesve Gjinorë në Raportin e Treguesve të Buxhetit Vjetor dhe Hartimi i Raporteve të Monitorimit: Për një transparencë më të madhe dhe një monitorim më të mirë, bashkia Elbasan duhet të përfshijë tregues gjinorë në raportin e treguesve të buxhetit vjetor dhe në raportin e performancës. Për më tepër, duhet të hartohen raporte të monitorimit për realizimin e këtyre treguesve gjinorë, në përputhje me shtojcën nr. 5 të Udhëzimit nr. 23, datë 30.07.2018 “*Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njëjësive të vetëqeverisjes vendore*”. Këto raporte do të ofrojnë informacion të detajuar mbi progresin dhe ndikimin e masave për barazinë gjinore, duke ndihmuar në rritjen e llogaridhënies së bashkisë.

9. Rritja e Peshës së Programeve të Shërbimeve Sociale për Kategoritë Vulnerabël në Buxhetin Vjetor: Për të mbështetur më mirë kategoritë vulnerabël, përfshirë gratë dhe vajzat, rekomandohet që bashkia Elbasan të rrisë peshën që zënë programet e shërbimeve sociale në buxhetin vjetor. Kjo rritje do të sigurojë që këto grupe të kenë qasje të përmirësuar në mbështetje sociale, strehim, trajnim profesional dhe shërbime të tjera të nevojshme që kontribuojnë në fuqizimin e tyre ekonomik dhe social.

10. Monitorimi i zbatimit të Planit Vendor për Barazinë Gjinore: Rekomandohet monitorimi i vijueshëm dhe përgatitja e raporteve vjetore të monitorimit për Planin Vendor për Barazinë Gjinore. Këto raporte do t’i mundësojnë bashkisë Elbasan jo vetëm një panoramë të nivelit të zbatimit të masave dhe aktiviteteve të parashikuara në Plan, por gjithashtu do të ndihmojnë në marrjen e masave për përmirësimin e situatës dhe ndërhyrjen në të gjitha aktivitetet që s’kanë mundur të realizohen.

11. Marrja e masave dhe organizimi i aktiviteteve për rritjen e ndërgjegjësimit të prindërve burra (baballarë të fëmijëve përfitues nga qendrat) për pjesëmarrjen e tyre aktive në kurset e prindërimit pozitiv: Në lidhje me këtë, sugjerohet rishikimi i tematikave të menduara për t’u zhvilluar me qëllim përfshirjen edhe të temave që lidhen me rolin dhe marrëdhënien midis babait dhe fëmijëve në familje.

## 4. Burimet e përdorura në analizë

### 1. Kuadri ligjor dhe institucional:

- Analiza e kuadrit ligjor dhe institucional për zbatimin e buxhetimit të përgjigjshëm gjinor në bashkinë Elbasan përfshiu disa aspekte kyçe:

a. Analiza e ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, i cili përshkruan përgjegjësitë financiare të autoriteteve vendore dhe detyrimin e tyre për integrimin e perspektivës gjinore në buxhet me fokus hartimin e buxheteve të përgjigjshme gjinore.

b. Analiza e udhëzimit të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësisve të vetëqeverisjes vendore”.

c. Analiza e masave të parashikuara në Strategjinë Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030 në terma të përfishrjes së BPGJ në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore.

d. Analiza e dokumentave strategjike vendore, me fokus Planin Vendor të Barazisë Gjinore, Planin Social Vendor, Planin për Integrimin e Pakicave Rome dhe Egjiptiane dhe planeve të tjera përkatëse të veprimit apo marrëveshjeve që synojnë adresimin e pabarazive gjinore dhe promovimin e përfshirjes sociale.

2. Statistikat zyrtare të ndara sipas gjinisë dhe të dhëna të tjera për sektorin/fushën e interesit:

a. Vlerësimi dhe analiza e statistikave gjinore në programet e shërbimeve sociale dhe të strehimit.

b. Statistika të punësimit në bashkinë Elbasan 2023.

3. Buxheti i bashkisë Elbasan për periudhën në analizë:

Vlerësimi i buxhetit të bashkisë për periudhën e caktuar përfshinte një vlerësim të plotë të dokumentave të ndryshme financiare, duke përfshirë:

a. Analiza e “Buxhetit 2023”, i cili prezantoi një pasqyrë të ndarjeve financiare brenda buxhetit të bashkisë Elbasan.

b. Shqyrtimi i Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) që shtrihet nga viti 2023 deri në vitin 2025, duke hedhur dritë mbi planifikimin financiar dhe ndarjen e fondeve për projekte dhe programe në harkun kohor trevjeçar.

c. Analiza e raportit të monitorimit dhe realizimit të buxhetit për vitin 2023.

ç. Analiza e anekseve të buxhetit për vitin 2023.

